

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj për “Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Brendshme
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jepni titullin e strategjisë ose të dokumentit të politikave që ka të bëjë me projektligjin.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	Data/Asnjë konsultim publik
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Data e vlerësimit të ndikimit
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti– ML – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Muhamet Rrumbullaku, <i>Email:</i> muhamet.rrumbullaku@shcba.gov.al Numri i telefonit: 0694159999
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<p><i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i></p> <p>Përgjatë zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë identifikuar një sërë problematikash që konsistojnë kryesisht në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mospërbushjen në kohë dhe efektive e qëllimit të këtij ligji për shkak të numrit të lartë të punonjësve që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik. • Pasaktësinë e terminologjisë dhe vakumit ligjor që ekziston në dispozitat e ligjit. • Mosparashikimin e një afati fundor për procesin e vlerësimit mbi të tre komponentët duke sjellë një proces të tejzgatur dhe joeficient që cenon besimin e publikut. • Mospërcaktimin e qartë në ligj mbi periudhën për të cilën do të kryhet verifikimi i pasurive të deklaruara dhe periudhës për të cilën do të vlerësohen/justifikohen pasuritë e deklaruara. 	

- Paqartësinë në parashikimet ligjore mbi kontrollin e figurës për sa i përket objektit, standardeve dhe rrethanave.
- Subjektivizmin në vlerësimin e aftësive profesionale si pasojë e vlerësimit mbi tre punët më të mira të zgjedhura nga subjekti.
- Mospërcaktimin e barrës së provës si element i hetimit administrativ.
- Mosparashikimin në ligj të rasteve të dorëheqjes gjatë hetimit administrativ.
- Mosparashikimin në ligj të detyrimit të institucioneve për zbatimin e vendimit.
- Koston e lartë që përkon me trajtimin financiar të punonjësve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik pranë tyre.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit?

Objektivat e përgjithshme:

- Reduktimi i fushës së zbatimit të ligjit 12/2018 i ndryshuar, referuar analizave dhe statistikave të realizuara për jetësimin e rekomandimeve të GRECO-s.
- Përcaktimi i një afati ligjor për kryerjen e procesit të vlerësimit.
- Plotësimi i vakumeve ligjore.
- Standardizimi dhe detajim i procedurave të vlerësimit për të tre komponentët: pasuri, figurë dhe profesionalizëm.
- Parashikimi i sanksioneve ligjore për t'i dhënë fuqi detyruese zbatimit të vendimit të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme.

Opsioni 0 – status quo-ja; Qëndrimi në gjendjen aktuale, duke mos ndërhyrë me nisma legislative nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër si dhe nuk reflekton ndryshimet që po pëson legjislacioni në vendin tonë.

Problematikat e evidentuara në përditshmërinë e punës të strukturave të ngarkuara me ligj për kryerjen e procesit të vlerësimit, nuk mund të zgjidhen nëpërmjet rrugëve të tjera jo legislative, si për shembull, ndërmarrja e fushatave sensibilizuese apo ndërgjegjësimi i subjekteve që preken nga ligji, publikut e të tjerë.

Opsioni 1 (rregullator): – Miratimi i një projektligji të ri, që konsiston në hartimin e disa ndryshimeve apo/dhe shtesave në ligjin aktual Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.

Opsioni 2 (rregullator): – Rregullimi me ligj të ri i procesit të vlerësimit duke shfuqizuar ligjin nr. Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura.

Opsioni i preferuar, rregullimi nëpërmjet një projektligji të ri për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin aktual që shoqërohet me këto ndikime:

Ndikimi ekonomik:

Kosto në buxhetin e shtetit:

Nisma ligjvënëse që synohet të ndërmerret, përmes ndërhyrjes së qeverisë, është vlerësuar se do të ketë impakt pozitiv ekonomik, në drejtim të reduktimit të kostove që përkojnë me trajtimin financiar të punonjësve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Ndikimet sociale:

- Afirmimi i punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe forcimit të besimit të publikut për rolin dhe kontributin e procesit të vlerësimit duke krijuar në vazhdimësi institucione të forta dhe të besueshme.
- Eliminimi i standarteve të dyfishta në vendimmarrje.
- Rritja e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut.
- Forcimi i transparencies.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është:

Opsioni 1 (rregullator): Miratimi i një projektligji të ri, që konsiston në hartimin e disa ndryshimeve apo/dhe shtesave në ligjin aktual Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndyshuar.

Me miratimin e këtij projektligji synohet që nëpërmjet disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara të garantohet një standard uniform vlerësimi pa prekur paanshmërinë, pavarësinë, objektivitetin dhe përputhjen e procesit të vlerësimit me parametrat e procesit të rregullt ligjor. Parimet e përgjithshme të realizimit të procesit të vlerësimit janë të njëjta si në ligjin ekzistues, por për shkak të disa problematikave të sipërpërmendura ka lindur nevoja për të hartuar këtë projektligj pa ndryshime thelbësore apo të përmbajtjes së ligjit.

Opsioni 1 (rregullator) gjykohet si opsioni i preferuar për shkak se nëpërmjet këtij projektligji me disa shtesa dhe ndryshime specifike mund të trajtohen të gjitha problematikat e identifikuara në vlerësimin e ndikimit.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara në opsionin 1 (rregullator), synohet që të ulen kostot e procesit të vlerësimit.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?)

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës, i ngritur me Urdhër të Ministrit të Brendshëm nr.26 datë 21.02.2022, me përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, njëkohësisht edhe grupe interesi. Në hartimin e projektligjit janë marrë në konsideratë edhe sugjerime të ngritura nga ILDKPKI si organ i ndihmës në kontrollin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Ky projektligj është konsultuar në mbledhjet e grupit të punës, përkatësisht në datat 25.02.2022, 02.03.2022 dhe 08.03.2022.

Referuar ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projekt aktit, përfundon brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

- Për zbatimin e opsionit të preferuar, do të ngarkohet Ministria e Brendshme, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore si institucioni kompetent për realizimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik.
- Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurinë Kombëtare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë krijohet një nënkomision, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Bazuar në një analizë të detajuar të situatës në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si edhe në kuadrin e hapave të hedhura nga reforma në drejtësi, është parë i domosdoshëm zhvillimi i një procesi vlerësimi të punonjësve të këtyre strukturave. Për të siguruar institucione të forta e të besueshme, me profesionistë me integritet, si dhe duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm dhe përfshirjen e punonjësve të Policisë së

Shtetit në hetimet ndaj veprave penale, u miratua fillimisht ligji nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”.

Mekanizmi i parashikuar në ligjin fillestar parashikonte ngritjen e një serie organesh, konkretisht Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, Komisioni Qendror i Vlerësimit dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit, për vlerësimin kalimtar të punonjësve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Brendshme, duke kryer një proces të plotë për kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Ky mekanizëm kërkonte impenjim domethënës të burimeve materiale dhe atyre njerëzore me një kosto të lartë financiare.

Për këtë qëllim, u propozua një mekanizëm i ri për vlerësimin, i cili mund të arrinte po të njëjtat objektiva, pra të pavarësisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të procesit, por me më pak kosto për buxhetin e shtetit, i cili u miratua në projektligjin e vitit 2019, ku u përcaktua që të ishte SHÇBA-ja ajo që do të kryente vlerësimin e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës në fazën e dytë dhe të tretë, pra punonjësit e nivelit të mesëm drejtues dhe atyre të nivelit bazë. Ndërkohë, në fazën e parë, do të vazhdonte Komisioni i Jashtëm të vlerësonte punonjësit që mbajnë grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe të gjithë punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Marrë shkas nga ecuria e ngadaltë e procesit të vetingut dhe me qëllim përmiresimin e efikasitetit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik sipas parashikimeve të ligjit 12/2018 të ndryshuar, ligjvënësi në ndryshimet e ligjit nr.74/2020 vendosi pezullimin e procesit të vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës, duke e orientuar punën e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit në përfundimin së pari të procesit të vlerësimit kalimtar për trupën e vlerësuese të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Ky ndryshim kishte për qëllim fokusimin dhe përmbylljen në kohë të procesit të vetingut për trupën vlerësuese të SHÇBA-së, e cila më tej do të mund të shtrinte objektin e vlerësimit kalimtar dhe periodik në subjektet e tjera të ligjit. Ky ndryshim vjen edhe në përputhje me rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë që asistojnë në çështjet e rendit dhe sigurisë dhe të gjithë problematikat e evidentuara prej tyre.

Duke analizuar veprimtarinë dhe rezultatet e deritanishme të këtij procesi, bazuar në arsyetime objektive si dhe në trendin e KJV-së, është arritur në konkluzionin që numri i subjekteve duhet domosdoshëmërisht të kufizohet.

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë faktin e ekzistencës së vakumit ligjor dhe paqartësisë në terminologji, që kanë sjellë vendimëmarrje me standard të dyfishtë, është parë e nevojshme dhe e domosdoshme ndërhyrja e qeverisë.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Ligji Nr.12/2018 aktual megjithëse ka parashikuar autoritetet kompetente për kryerjen e veprimtarisë verifikuese dhe vlerësuese, subjektet që do t'i nënshtrohen vlerësimit

kalimtar/periodik, si dhe procedurat e vlerësimit për të tre komponentët pasuri, figurë dhe profesionalizëm, ka paraqitur disa mangësi dhe problematika që vijnë nga:

- Tejzgjatja e afateve të procesit të vlerësimit duke zbehur efektivitetin dhe qëllimin primar të krijimit të këtij ligji. Numri i lartë i punonjësve që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit, rreth 12,000 punonjësve,
- Evidentimi i vakumeve dhe keqintepretime të dispozitave të ndryshme, të cilat lenë vend për subjektivizëm, pasiguri juridike, cënim të procesit të rregullt ligjor dhe standarde jo të qarta gjatë procesit të vlerësimit.
- Mosparashikimi i qartë i një periudhe të caktuar kohore brenda së cilës do të kryhet procesi i vlerësimit për të tre komponentët.
- Paqartësia mbi periudhën në të cilën do të shtrihet verifikimi dhe vlerësimi i pasurive të deklaruara nga subjekti i vlerësimit.
- Mospërcaktimi i qartë i objektit dhe rrethanave rënduese dhe lehtësuese në parashikimet ligjore mbi kontrollin e figurës.
- Evidentimi i subjektivizmit që mund të lindë si rezultat i përzgjedhjes së tre punëve më të mira nga vetë subjekti në komponentin e vlerësimit të aftësive profesionale.
- Mungesa e parashikimit të të gjithë elementëve të nevojshëm për një proces të rregullt administrativ.
- Mosparashikimi i rasteve të dorëheqjes gjatë hetimit administrativ si një e drejtë kushtetuese, por edhe e materializuar në kontratën individuale të punës, apo në aktet ligjore që normojnë këtë marrëdhënie.
- Mungesa e parashikimit të detyrimit për zbatim të vendimeve të trupave të vlerësimit nga ana e institucioneve përkatëse.

Grupet e prekura nga ky problem janë punonjësit e:

1. Policisë së Shtetit
2. Gardës së Republikës
3. Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

- **Arsyeja e ndërhyrjes**

1. *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*

Ligji aktual paraqet disa problematika mbi numrin e larte te subjekteve ne vleresim, me terminologjinë, vakumin ligjor, mosparashikimin e qartë të periudhës së vlerësimit në lidhje me realizimin e procesit të vlerësimit duke sjellë vendimmarrje më standarde të dyfishta dhe cënim të sigurisë juridike.

2. *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*

Nëpërmjet kësaj nisme qeveria shpreson rregullimin e disa procedurave dhe standardeve të procesit të vlerësimit kalimtar/periodik duke dhënë një kontribut real për afirmimin e punonjësve profesionistë dhe me integritet të lartë të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nëpërmjet zbatimit të parimit të integritetit, rritjes profesionale dhe garantimit të një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar në vazhdimësi institucione të forta dhe të besueshme.

3. *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

Kjo ndërhyrje synon:

- të garantojë zbatimin e parimit të integritetit, rriten e profesionalizmit dhe garantimin e një karriere të drejtë;
- të ulë kostot e procesit;
- të shpejtojë kohën e shqyrtimit të rasteve individuale;
- të garantojë një standard uniform vlerësimi në përputhjen me parametrat e procesit të rregullt ligjor;
- të garantojë pavarësi dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit.

4. *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Përsa i përket punës ekzistuese për hartimin e projektligjit grupet e interesit që përfshijnë përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore të cilët pas kryerjes së disa takimeve dhe marrjes së mendimeve/sugjerimeve kanë dalë në një rezultat final duke marrë në konsideratë edhe sugjerime të ngritura nga ILDKPKI si organ i ndihmës në kontrollin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, reale dhe në kohë.*

Konkretisht, objektivat rezultojnë si më poshtë vijon:

- Implementimi i rekomandimeve të GRECO-s, ku fokus kryesor është reduktimi i numrit të subjekteve që i nënshtrohen vlerësimit kalimtar, duke u përqendruar tek nivelet menaxheriale dhe strukturat me risk të lartë korrupsioni, me qëllim shmangien e pasigurisë juridike dhe mënjanimin e presionit të vazhdueshëm të punonjësit të organizatës për të rritur efektivitetin në mbarëvajtjen e punës.
- Saktësimi i terminologjisë dhe plotësimin e vakumit ligjor me qëllim shmangien e konfuzionit dhe keqinterpretimit të dispozitave të ligjit.
- Rregullimi dhe standartizimi i procedurave të vlerësimit kalimtar për:
 - ndryshimin dhe rikonceptimin e procesit të vlerësimit të pasurisë në lidhje me përcaktimin e periudhës së vlerësimit (nga viti 2008 dhe në vazhdim) dhe rolin e ILDKPKI-së në funksion të këtij procesi;
 - qartësimin e objektit të kontrollit të figurës, saktësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese dhe parshikimin e rolit të strukturës përgjegjëse të AMP-së mbi komponentin e figurës;
 - riformulimin e procedurës së aftësive profesionale duke rishikuar periudhën e vlerësimit, si dhe burimet nëpërmjet vlerësimit nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardeve profesionale, ku në përfundim të shqyrtimit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të vlerësimit të aftësive profesionale.
- Rikonceptimi i procesit të vlerësimit periodik me një frekuencë 5 vjeçare, për të gjithë ata punonjës brenda kategorisë së subjekteve që kalojnë më parë procesin e vlerësimit kalimtar. Vlerësimi periodik konsiderohet i domosdoshëm për të sjellë një efekt të drejtëpërdrejtë parandalues për punonjësit objekt i këtij ligj (shef komisariati e lart), ku mundësia e abuzimit të detyrës gjatë ecurisë në karrierë është potencialisht më e lartë.

- Përcaktimi i një afati fundor për procesin e vlerësimit mbi të tre komponentët e vlerësimit. Procesi i vlerësimit do të shtrihet në një afat kohor prej 180 ditë pune nga momenti i fillimit të hetimit kryesisht.
- ILDKPKI, struktura përgjegjëse pranë AMP-së dhe burimet njerëzore/standardet profesionale brenda 120 ditëve nga kërkesa e trupës së vlerësimit duhet të të paraqesin një raport të hollësishtëm dhe të arsyetuar për komponentët përkatës.
- Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore do të kenë detyrimin që, brenda 60 ditëve nga marrja në dorëzim të raportit nga struktura përkatëse, me të drejtë shtyrje deri në 30 ditë, të kryejnë hetime shtesë nëse gjykojnë të nevojshme dhe të përfundojnë hetimin administrativ.
- Përcaktimi i afatit ligjor të dorëzimit të deklaratave nga subjektet e deklarimit.
- Rregullimi dhe përcaktimi e rasteve dhe pasojave të dorëheqjes së subjekteve gjatë procesit.
- Parashikimi i “Barrës së Provës” si një element i hetimit administrativ.
- Parashikimi i ndërprerjes së mandatit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit duke marrë shkas nga ecuria e procesit të vlerësimit e cila cënon parimin e sigurisë juridike dhe rrit koston financiare të procesit.
- Detyrimi i institucioneve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës nëpërmjet një dispozite ligjore për zbatimin e vendimit të Trupave të Vlerësimit.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Opsioni 0 : status quo-ja – Ky opsion nuk sjell asnjë ndryshim, dhe nuk rregullon problematikat e hasura gjatë zbatimit të ligjit si dhe e thellon edhe më shumë hendekun dhe vakumin ligjor në realizimin e misionit dhe kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të subjekteve të Ministrisë së Brendshme.

Qëndrimi duke mos ndërhyrë me nisma legjislativë nuk përmbush objektivat e përcaktuara më sipër, si dhe nuk i jep zgjidhje problematikave të hasura gjatë përditshmërisë së punës të strukturave të ngarkuara me ligj për realizimin e procesit të vlerësimit.

Opsioni 1 (rregullator): – Miratimi i një projektligji të ri, që konsiston në hartimin e disa ndryshimeve apo/dhe shtesave në ligjin aktual Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, do të zgjidhë problematikat dhe vështirësitë e hasura nga praktika dhe do të mundësojë:

- Reduktimin e numrit të subjekteve që do të vlerësohen, duke sjellë një proces efikas, eficient dhe jo bllokues, si edhe në përputhje me rekomandimet e Greccos.
- Realizimin në kohë i një procesi vlerësimi të rregullt ligjor.
- Realizimin e një hetimi të plotë administrativ me të gjithë elementët e tij.
- Zbatueshmërinë nga ana e institucioneve të vendimeve të marra nga trupat e vlerësimit.
- Ndikim pozitiv në buxhetin e shtetit.

Ky opsion mundëson arritjen e objektivave të njëjta, pra të pavarësisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të procesit, por me më pak kosto për buxhetin e shtetit.

Opsioni 2 (rregullator): – Rregullimi me ligj të ri i procesit të vlerësimit duke shfuqizuar ligjin Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” dhe të gjitha aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk është gjykuar si opion i preferuar, pasi problematikat e hasura nga zbatimi i ligjit aktual, si dhe ndërhyrjet që parashikohen të bëhen, nuk prekin më shumë se 50% të përmbajtjes së aktit aktual, ndaj nuk lind nevoja e hartimit të një akti të ri. Gjithashtu, duke qenë se kriteret e vlerësimit nuk ndryshojnë nga ligji aktual, sikurse nuk ndryshon dhe qasja e arritjes së objektivave. Opsioni 2 do të sillte vonesa në plotësimin e objektivave të politikës, pasi miratimi i një projektligji tërësisht të ri, kërkon më shumë kohë për shqyrtim dhe për rrjedhojë dhe për miratimin e tij.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. Identifikoni grupet e prekura.

2. Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.

3. Për ndikimet e drejtpërdrejta:

a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.

b. Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.

c. Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).

d. Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).

4. Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

a. Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.

b. Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.

5. Diskutoni kufizimin e analizës:

a. Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.

b. Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.

6. Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

a. Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.

b. Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.

c. Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).

Grupet e prekura dhe ndikimi i drejtpërdrejtë mbi këto grupe:

Grupet e prekura nga hartimi dhe miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, listohen si më poshtë:

1. **Policia e Shtetit**

2. **Garda e Republikës**

3. **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**

Referuar ecurisë së reformës në drejtësi, krahas prokurorëve edhe gjyqtarëve, legjislatori ka gjykuar që edhe subjektet e sipërpërmendur t'i nënshtrohen një procesi të mirëfilltë kontrolli dhe verifikimi, për shkak të funksioneve dhe impaktit që kanë.

Nisur nga fakti që punonjëit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore mbajnë funksione me risk të madh korrupsioni, për shkak të fushës së veprimtarisë dhe proceve të punës vendimmarrëse, janë gjykuar si subjekte që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit konkretisht në pozicionet:

- a. *drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor në strukturat e vecanta, drejtor e zëvendësdrejtor vendor, drejtor në drejtoritë e kufirit dhe migracionit, shef komisarati, shef sektori në nivel qendror e vendor që mbulon fushën e krimin të organizuar, krimin ekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit.*
- b. *drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie dhe shef njësie në Gardën e Republikës;*
- c. *drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, shef sektori në nivel qendror dhe vendor, si dhe punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimit kalimtar/periodik në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore.*

Miratimi i këtij projektligji do të ketë ndikim të drejtëpërdrejtë dhe jo të drejtëpërdrejtë mbi grupet e sipërpërmendura.

• **Ndikimet e drejtëpërdrejta:**

1. Garantimi i sigurisë juridike, i të drejtave dhe lirive themelore të këtyre subjekteve nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.
2. Afirmimi i punonjësve që udhëhiqen nga parime dhe vlera të larta morale, të dedikuar dhe të përkushtuar, mbi të cilën do të ngrihen institucionet e nesërme ligjzbatuese.
3. Identifikimi i pjesës së shëndoshë dhe me integritet të cilët duhet të vlerësohen gjatë ecurisë në karrierë.

Referuar fakti që ky ligj ka në thelb procesin e vlerësimit të subjekteve për tre komponent pasuri, figurë dhe profesionalizëm, çdo pasojë e sjellë nga ky ligj reflekton ndikime të drejtëpërdrejta në grupet e prekura.

• **Kosto në buxhetin e shtetit:**

Nisma ligjvënëse që synohet të ndërmerret, përmes ndërhyrjes së qeverisë, është vlerësuar se nuk do të ketë një kosto të shtuar financiare, përkundrazi do të sjell një impakt pozitiv në buxhetin e shtetit.

• **Ndikimet sociale:**

- Rritja e performancës dhe shërbimeve ndaj qytetarit.
- Rritja e sigurisë në komunitet duke respektuar të drejtën e qytetarëve.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe forcimit të besimit të shoqërisë për rolin dhe kontributin e punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- Rritja e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut në komunitet në kuadër të bashkëjetesës shoqërore.

- Forcimi i transparencës.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*

Opsioni 1 (rregullator): Miratimi i një projektligji të ri, që konsiston në hartimin e disa ndryshimeve apo/dhe shtesave në ligjin aktual Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndyshuar.

Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj synon garantimin e një standardi të unifikuar duke mos ndikuar në paanshmërinë, pavarësinë, objektivitetin dhe kryerjen e procesit të vlerësimit të vettingut me parametrat e një procesi të rregullt ligjor. Parimet e përgjithshme të realizimit të procesit të vlerësimit janë të njëjta si në ligjin ekzistues, por për shkak të disa problematikave të sipërpërmendura ka lindur nevoja për të hartuar këtë projektligj pa ndryshime thelbësore apo të përmbajtjes së ligjit.

- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Për sa u analizua dhe shtjellua më sipër, gjykohet se opsioni i preferuar është Opsioni 1 (rregullator), për shkak se nëpërmjet këtij projektligji me disa shtesa dhe ndryshime specifike mund të trajtohen dhe t’i jepet zgjidhje të gjitha problematikave të identifikuara, si vijon:

- a. Jetësimin e rekomandimeve të GRECO-s, nëpërmjet reduktimit të numrit të subjekteve të vlerësimit duke u bazuar në analiza rrisht dhe ngjasave për të qenë më të ekspozuar ndaj aferave korruptive.
- b. Parashikimin e një afati ligjor për kryerjen e procesit sjell një proces efikas dhe konkret duke sjellë rezultate konkrete.
- c. Plotësimin e vakumeve ligjore duke eliminuar aplikimin e standarteve të dyfishta të vendimmarrjes nga trupat e vlerësimit, duke mos lënë vend për interpretime abuzive.
- d. Standardizimin dhe detajimin e procedurave të vlerësimit për të tre komponentët duke lehtësuar punën e trupave të vlerësimit dhe duke paraqitur një tablo me të qartë dhe transparente për grupet e interesit dhe publikun e gjerë.
- e. Zbatimin e vendimit përfundimtar të trupave të vlerësimit nga institucionet përkatëse, duke materializuar fuqi detyruese të një akti administrative të dalë nga institucioni i vlerësimit i ngarkuar nga legjislatori për kryerjen e procesit.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*

Institucioni përgjegjës për procesin e vlerësimit është Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, e cila organizon trupa vlerësimit për këtë qëllim. Këto trupa gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, zbatojnë procedurat e parashikuara në këtë projektligj, në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale” dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

Trupat e Vlerësimit janë të organizuara në formën e organit kolegjal përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve ndaj subjekteve që do të vlerësohen, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, të përbëra nga tre anëtarë, të cilët caktohen me short.

- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
 - a. Procesi i vlerësimit kalimtar dhe periodik është një proces kompleks në të cilin marrin pjesë jo vetëm trupat e vlerësimit por edhe aktorë të jashtëm ndihmës si ILDKPKI (*për komponentin e pasurisë*), Struktura përgjegjëse pranë AMP-së (*për komponentin e figurës*) dhe burimet njerëzore/standardet profesionale pranë institucioneve përgjegjëse (*për komponentin e profesionalizmit*). Pjesëmarrja e tyre mund të sjellë vonesa në proces duke mos zbatuar afatet e përcaktuara në ligj për paraqitjen e raporteve pranë Agjencisë së Mikëqyrjes Policore.
 - b. Korrespondenca me institucionet dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese është një tjetër faktor që mund të vonojë realizimin e procesit të vlerësimit.
 - c. Vështirësitë që mund të krijohen nga pamundësia e subjekteve për të siguruar në kohën e duhur dokumentacionin e nevojshëm provues.
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
 - a. Miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të këtij ligji.
 - b. Hartimin e akt-marrëveshjeve mbi përcaktimin e pikave të kontaktit, nëpërmjet AMP-së dhe institucioneve ligjzbatuese, në funksion të fillimit të procesit të vlerësimit me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe përcaktimin e modaliteteve për realizimin e shkëmbimit të informacionit me qëllim kryqëzimin dhe ballafaqimin e tyre, në raport me deklaratimet e subjekteve të vlerësimit dhe personave të lidhur me ta.
 - c. Forcimi i bashkëpunimit dhe përfshirja e publikut në procesin e vlerësimit

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*

Monitorimi i zbatimit të opsionit të preferuar do të kryhet nga:

1. Nënkomisioni në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurinë Kombëtare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet.
2. Ministria e Brendshme.
3. Agjencia e Mikëqyrjes Policore, si institucioni kompetent për realizimin e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik.
4. Partnerë ndërkombëtarë, ku bëjnë pjesë organizatat ndërkombëtare dhe misionet e huaja që asistojnë Ministrinë e Brendshme, me të cilat trupat e vlerësimit konsultohen për aspekte teknike të vlerësimit të subjeteve.

- *Kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave*

1. Monitorimi konstant i zbatimit të opsionit të preferuar do të kryhet nëpërmjet raportimeve periodike të ecurisë së procesit të vlerësimit nga institucioni përgjegjës për këtë proces.
2. Numri i subjekteve që përfundojnë me sukses procesin e vlerësimit.
3. Numri i vendimeve të shpallura brenda 3-mujorit të I-rë nga hyrja në fuqi e këtij projektligji.
4. Ekzekutimi nga institucionet përkatëse të vendimeve të trupave të vlerësimit pranë AMP-së.
5. Gatishmëria e institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë për dhënien e informacionit brenda/përpara afatit ligjor të përcaktuar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur = Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës										

Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR